

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 9 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 8 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të Rregullores së punës të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele 601-4351/1 datë 29.8.2014, dhe në pajtim me Konkluzinin e Këshillit të Agjencisë nr.02-7050/3 datë 18.12.2015, miratuar në seancën e 40-të e mbajtur më 18.12.2015, u përgatit Tekst i pastruar i Rregullores për; veshje zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele e cila përfshin: Rregulloren për veshje zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë, nr.01-1880/1 datë 12.3.2015, Rregulloren nr.01-5504/1 datë 18.09.2015 për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veshje zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë, nr.01-1880/1 datë 12.3.2015 dhe Rregulloren, nr.01-5504/2 datë 18.12.2015 për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veshje zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë, nr.01-1880/1 datë 12.3.2015 dhe nr. 01-5504/1 datë 18.9.2015.

**Rregullore për veshje zyrtare dhe këpucë për të punësuarit, për personat që janë të angazhuar si bashkëpunëtor të jashtëm dhe të brendshëm në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele**

**(Tekst i pastruar)**

**1. Dispozita të përgjithshme**

**Neni 1**

Në këtë Rregullore përcaktohen vendet e punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e cila parashikon mbajtje të detyrueshme të veshjes zyrtare, llojin e veshjes zyrtare, materialin përbërës të veshjes zyrtare dhe kohën e përdorimit të saj.

Për punonjësit e Agjencisë, të cilët caktohen në vendet e punës në pajtim me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me Shtojcë nr.1 — Kontroll tabelar të vendeve të punës dhe titujve, përkatësisht ndaj personave që janë të angazhuar si bashkëpunëtor të jashtëm, në të cilën kjo Rregullore parashikon mbajtjen e detyrueshme të veshjes zyrtare, si veshjen dimërore dhe verore, pa kompensim.

**Neni 2**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele obligohet për të siguruar veshje zyrtare për të punësuarit përkatësisht ndaj personave që janë të angazhuar si bashkëpunëtorë të jashtëm në Agjencion, që janë të vendosur në vendet e punës, si në vijim: punëtor në kuzhinë, shofer, dërgues, punëtor në sportel dhe kujdestar.

Nëse punonjësit e vendeve të punës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i mbajnë veshjet zyrtare, ata bëjnë shkelje të detyrave në punë.

## **2. VESHJA ZYRTARE NË AGJENCION**

### **Neni 3**

Veshja zyrtare, në varësi të stinës së cilës i referohet, mund të jetë dimërore dhe verore.

Veshja zyrtare dimërore vishet në periudhën nga 15tetori deri më 31 mars, ndërsa veshja zyrtare verore vishet në periudhën nga 1 prilli deri më 14 tetor.

Në varësi të kushteve atmosferike, drejtori i Agjencisë miraton urdhër me shkrim për veshjen dimërore dhe verore, ku veshjet zyrtare mund të mbahen përtej periudhës së përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni.

Punonjësi është i detaruar që veshjen zyrtare ta mbajë gjatë gjithë kohës në punë dhe ta mirëmbajë në gjendje të rregullt.

Veshja zyrtare nuk mund të jipet. Nuk mund të bëhen dhe ndryshime që vijnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

### **Neni 4**

Veshja zyrtare dimërore për meshkuj përbëhet nga: kostum klasik dimëror (pallto dhe pantallona), këmishë me mëngë të gjata dhe kravatë.

Veshja zyrtare verore për meshkuj përbëhet nga: kostum klasik veror (pallto dhe pantallona), këmishë me mëngë të shkurtra dhe kravatë.

### **Neni 5**

Veshja zyrtare e dimrit për gratë përbëhet nga një fund ose pantallona dhe pallto, këmishë me mëngë të gjata, shall dhe jelek.

Veshja zyrtare verore përbëhet nga: fund veror ose pantallona dhe këmisha me mëngë të shkurtra, shall ose jelek.

Për të punësuarit në kuzhinë, përveç veshjes zyrtare u sigurohen dhe këpucë.

### **Neni 6**

Veshjet zyrtare dimërore duhet të kenë përbërjen e mëposhtme të pëlhurës:

-kostum klasik dimëror (pallto, pantallona apo fund) me përbërje të leshtë 45% dhe poliestër 55%, me një devijim të lejuar prej 5%,

-këmisha me mëngë të gjata me përbërje pambuku 70% dhe poliestër 30%, me një devijim të lejuar prej 5%,

-kravata me përbërje 100% poliestër dhe shalle me përbërje 100% poliestër.

Veshjet zyrtare verore duhet të përmbajnë këtë përbërje të pëlhurës:

-kostum klasik veror (pallto, pantallona ose fund dhe jelek) me përbërje poliestër 80% dhe material viskozë 20%, me një devijim të lejuar prej 5%

-kravata me përbërje 100% poliestër dhe shalle, me përbërje 100% poliestër.

-shalle me përbërje 100% poliestër

-këmisha me mëngë të shkurtra me përbërje 70% pambuk dhe poliestër 30%, me një devijim të lejuar prej 5%.

### **Neni 7**

Veshjet zyrtare kanë prerjet e mëposhtme:

-Pallto - me prerje të zakonshme dhe mbërthehet me 3 (tre) kopsa. Përpara nga të dy anët nga 1 (një) xhep i veshur me astar në ngjyrën e materialit,

-pantallona-(dimri dhe verore) me prerje të zakonshme. Përpara në të dy anët kanë nga 1 (një) xhep të pjerrët me numër të nevojshëm të ylykëve për vendosjen e rripit.Pantallonat deri në mbi gjunjë janë me astar të brendshëm me ngjurë të materialit të kostumit.Në anën e djathtë të mbrapme ka xhep ma madhësi standarte 14 cm,

-kravatë-me një prerje të rregullt,

- fund-me një prerje të rregullt, me hapje të pasme për zinxhir deri në 20 cm në pjesën e brendshme me ngjyrë të përshtatshme.Në brez ka i (një) kopës.Fundi është në gjatësi standarte, deri tek gjuri,

-këmishë me mëngë të shkurtra dhe të gjata-me prerje të zakonshme dhe 1 (një) xhep në anën e majtë dhe

-jelek burrash me prerje të zakonshme, me 3 (tre) kopsa dhe me nga 1 (një) xhep nga të dy anët, me madhësi standarte.

Pjesët e veshjes zyrtare në anën e brendshme në vendin e duhur kanë të vendosur etiketën me shenjën e prodhuesit, madhësinë, si dhe udhëzimet për mirëmbajtje.

Neni 8

Kohëzgjatja e veshjeve zyrtare është:

| Numri rendor                                                 | Emri                      | Sasia | Kohëzgjatja |
|--------------------------------------------------------------|---------------------------|-------|-------------|
| <b>A) Pjesë të veshjeve zyrtare dimërore Punëtor kuzhine</b> |                           |       |             |
| 1.                                                           | Fund ose pantallona       | 3     | 12 muaj     |
|                                                              | pallto                    | 3     |             |
| 2.                                                           | këmishë me mëngë të gjata | 5     | 12 muaj     |
| 3.                                                           | kravatë ose shallë        |       |             |
| <b>B) Pjesë të veshjeve zyrtare verore</b>                   |                           |       |             |
| 1.                                                           | Fund ose pantallona       | 3     | 12 muaj     |

3

|                                                                       |                              |   |         |
|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------|---|---------|
| 2.                                                                    | këmishë me mëngë të shkurtra | 5 | 12 muaj |
| 3.                                                                    | jelek                        | 3 | 12 muaj |
|                                                                       | këpucë                       | 1 | 12 muaj |
|                                                                       | kravatë ose shallë           |   |         |
| <p>-Shofer, dorëzues<br/>-Punëtor recepcioni<br/>-Roje(kujdestar)</p> |                              |   |         |

| A) Pjesë të veshjeve zyrtare dimërore |                              |                     |   |         |         |
|---------------------------------------|------------------------------|---------------------|---|---------|---------|
| 1.                                    | •kostum klasik               | .pallto             | 3 | 12 muaj |         |
|                                       |                              | Fund ose pantallona | 3 |         |         |
| 2.                                    | këmishë me mëngë të gjata    |                     |   | 5       | 12 muaj |
| 3.                                    | kravatë ose shallë           |                     | 2 | 12 muaj |         |
| B) Pjesë të veshjeve zyrtare verore   |                              |                     |   |         |         |
| 1.                                    | kostum klasik                | pallto.             |   | 12 muaj |         |
|                                       |                              | Fund ose pantallona | 3 |         |         |
| 2.                                    | këmishë me mëngë të shkurtra |                     |   | 5       | 12 muaj |
| 3.                                    | kravatë ose shallë           |                     | 2 | 12 muaj |         |

Kohëzgjatja e veshjes zyrtare përkatësisht afatet nga paragrafi 1 i këtij ligji fillojnë të zbatohen që nga dita kur të punësuarit përkatësisht punonjësit e angazhuar nga jashtë në Agjencion, janë pranuar, përkatësisht janë të pajisur me veshjen zyrtare.

### Neni 9

Nëse të punësuarit përkatësisht bashkëpunëtorët e jashtëm të angazhuar në Agjencion mungojnë në punë më shumë se 6 (gjashtë) muaj pa marrë për bazë arsyen, afati i kohëzgjatjes së veshjes zyrtare, përkatësisht i pjesëve të veçanta të veshjes zyrtare, vazhdon për aq kohë sa vetë i punësuarit përkatësisht bashkëpunëtori i jashtëm i angazhuar në Agjencion mungon në punë.

### Neni 10

Pas skadimit të afatave sipas nenit 8 të kësaj Rregulloreje, veshja zyrtare kalon në pronësi të të punësuarit të cilit i është dhënë.

### Neni 11

Nëse punonjësi, përkatësisht bashkëpunëtori i jashtëm i punësuar në Agjencion e ndërpret punësimin e tij para skadimit të mandatit kohëzgjatja e veshjes zyrtare, punonjësi ose bashkëpunëtori i jashtëm mund të mbajë veshjen zyrtare duke paguar tarifë.

Dispozita e paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohet në rast të humbjes së jetës të të punësuarit/bashkëpunëtorit të angazhuar nga jashtë, ose në rast të daljes në pension.

### Neni 12

Nëse veshja zyrtare, gjegjësisht pjesë e veshjes zyrtare punonjësi/bashkëpunëtori i jashtëm i angazhuar e dëmton ose shkatërron me fajin e tij, duhet të paguajë dëmshpërblim për blerje të veshjes zyrtare të re ose të pjesës së dëmtuar.

Nëse veshja zyrtare ose një pjesë e caktuar e veshjes zyrtare është shkatërruar ose dëmtuar pa fajin e punonjësit/bashkëpunëtorit të jashtëm të angazhuar, ai ka të drejtë në veshje zyrtare të re, pa paguar dëmshpërblim(kompensim).

### **3. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 13**

(Neni 13 i Rregullores për veshjen dhe këpucët zyrtare për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1880/1 datë 12.3.2015)

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vepruari Rregullorja për veshjet zyrtare për të punësuarit në shërbimin profesional të Këshillit për transmetim nr.02-2855/1 datë 26.9.2008.

#### **Neni 14**

(Neni 14 i Rregullores për veshjen zyrtare për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1880/1 datë 12.3.2015)

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj dhe do të shpallet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

#### **Neni 15**

(Neni 9 i Rregullores nr.01-5504/1 datë 18.9.2015 për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veshjen zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1880/1 datë 12.3.2015)

Kjo Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veshjen zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1880/1 datë 12.3.2015, hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj dhe do të shpallet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

#### **Neni 16**

(Neni 5 i Rregullores nr.01-5504/2 datë 18.12.2015 për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veshjen zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-1880/1 datë 12.3.2015 dhe nr. 01-5504/1 datë 18.9.2015)

Kjo Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për veshje zyrtare dhe këpucë për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.01-1880/1 datë 12.3.2015 dhe nr.01-5504/1 datë 18.9.2015, hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj dhe do të shpallet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

**Nr.01-7164/1/1**  
**25.12.2015**  
**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuele**  
**Kryetar i Këshillit,**  
**Lazo Petrushevski d.v**